



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ Prot.

Fier, më ___/___/2024

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit Paraparak për procedurën me objekt:
“Blerje elektropompa zhytëse e panele”, me burim financimi nga Buxheti i “Shoqëria
Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier” Sh.a.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 10

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Data: 30.04.2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik “VASAA” shpk

Adresa: Fier L. KRYENGRITJA E FIERIT

NUIS J62903470T

Procedura e prokurimit: E hapur, me mjete elektronike (mallra).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-97126-03-04-2024**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje elektropompa zhytëse e panele” me fond limit prej **18,000,000 (tetëmbëdhjetë milion) lekë pa TVSH**, me burim financimi nga Buxheti i “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier” Sh.a, në përputhje me sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Objekti i prokurimit do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet (lëvrohet), me vlerë dhe sasi të plotë brenda afatit të lëvrimin. Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 12 muaj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [11 Mars 2024] [14].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- Operatori ekonomik “ASI-2A CO” shpk, me NIPT K53002402C, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **15.000.000** (pesëmbëdhjetë milion) lekë pa TVSH, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1.
- Operatori ekonomik “INPLY” shpk me NIPT L51503032Q, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **17.800.000** (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1.
- Operatori ekonomik “MIKAEL-GRUP” shpk, me NIPT K64108001G, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike sipas shtojcës 1.
- Operatori ekonomik “SAHORA” shpk, me NIPT L91703022T, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **16.690.000** (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1.
- Operatori ekonomik “VASAA” shpk, me NIPT J62903470T, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total **13.940.000** (trembëdhjetë milion e nëntëqind e dyzetë mijë)lekë pa TVSH, me çmime të paraqitura sipas shtojcës 1.
- Operatori ekonomik person fizik **Vasil Belishta** me NIPT L74605006C, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike sipas shtojcës 1.

❖ Nga pjesëmarrësit janë **skualifikuar** ofertuesit:

1. Operatori ekonomik “ASI-2A CO” shpk me NIPT K53002402C, **nuk ka paraqitur** dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, sepse:

- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.1 të Kapacitetit profesional, pasi referuar ekstraktit të QKB, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- Nuk plotëson kriterin teknik të pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik në DST, pasi faturat elektronike të paraqitura, kanë si element situacione të objektit të projektit të padetajuar në zëra dhe nuk përbën dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

* **Në këto kushte, ky operator ekonomik skualifikohet.**

2. Operatori ekonomik “INPLY” shpk me NIPT L51503032Q, **nuk ka paraqitur** dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, sepse:

- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.1 të Kapacitetit profesional, pasi referuar ekstraktit të QKB, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të DST.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Çertifikatën e Cilësisë **ISO 9906:2012 të klasës 3B; më të lartë** ose (ekuivalente me të) mbi konformitetin e standardeve europiane të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

* **Në këto kushte, edhe ky operator ekonomik skualifikohet.**

3. Operatori ekonomik “MIKAEL-GRUP” shpk me NIPT K64108001G, **nuk ka paraqitur** dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, sepse mungojnë:

- Oferta ekonomike
- Sigurim oferte
- Formular vetdeklarimi
- Bilancet 2021-2022
- Furnizime të mëparshme të ngjashme
- Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar
- Katalog prodhuesi
- Deklaratë transporti

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

* **Ky operator ekonomik skualifikohet.**

4. Operatori ekonomik “SAHORA” shpk me NIPT L91703022T, **nuk ka paraqitur** dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, pasi:

- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.1 të Kapacitetit profesional, pasi referuar ekstraktit të QKB, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

* **Ky operator ekonomik skualifikohet.**

5. Operatori ekonomik person fizik Vasil Belishta me NIPT L74605006C, **nuk ka paraqitur** dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit publik, pasi:

OE ka paraqitur vetëm ekstraktin e QKB dhe asnjë prej dokumentave të tjerë të kërkuar për kualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

***Në këto kushte, ky operator ekonomik skualifikohet.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“VASAA” shpk**, me **NIPT J62903470T** dhe adresë *Fier L. KRYENGRITJA E FIERIT*, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **13,940,000 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e dyzetë mijë) lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PETRIT KANANI**